




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u mbështetur në nenin 49 paragrafi 2.1, nenin 102 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01.Nr.16-53125 të datës 11.11.2011, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 21.09.2012, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 28.09.2012, miraton këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E NDRYSHIMEVE DHE PLOTËSIMEVE TË
RREGULLORËS PËR TATIMIT NË PRONËN E PALUAJTËSHME PËR VITIN
TATIMOR 2013

I

Me këtë vendim aprovohen ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Komunën e Gjilanit nga viti tatimor 2013.

II

Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores mbi tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2013, kanë të bëjnë me ndryshimin e vlerave tatimore të pronat rezidenciale.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Komunën e Gjilanit për vitin tatimor 2013.

IV

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej vendimi 01.Nr.16/41523 i datës 28.09.2011, për aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2012.

V

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilanit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit, ndërsa aplikohet nga data 01.01.2013.

01.Nr. 16-113374
Gjilan, më 28.09.2012

Kuvendi i komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues